| Radio "Kiss FM"            | Shoqëria "Kiss FM" sh.p.k.                             | Gentian Sula                     | (100%)        |
| Radio "Durrësi"            | Shoqëria "RTV Adria-Med" sh.p.k.                       | Gentian Ferhati<br>Enver Mehmeti | 60%)<br>(40%) |
| Radio "House of Arts"      | Shoqëria "House of Arts Radio Televizion shpk" sh.p.k. | Elona Jegeni                     | (100%)        |
| Radio "Fantasy"            | Shoqëria "Emi Advertisment CO" sh.p.k.                 | Elvi Fundo                       | (100%)        |
| Radio "DJ 98.2"            | Shoqëria "Radio Network Albania" sh.p.k.               | Lorena Avdija                    | (100%)        |
| Radio "Sol"                | Shoqëria "Radio Sol" sh.p.k.                           | Tedi Xhori                       | (100%)        |
| Radio "Saranda Ime" sh.p.k | Shoqëria "Radio Televizioni Saranda" sh.p.k            | Thodhori Dukshi                  | (100%)        |

## Radio komunitare

|                  |                                                |
|------------------|------------------------------------------------|
| Radio "Spektrum" | Komuniteti Musliman i Shqipërisë               |
| Radio "Maria"    | Shoqata "Radio Maria"                          |
| Radio "Ngjallja" | Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë        |
| Radio "Dodona"   | Kryegjyshata Botërore Bektashiane e Shqipërisë |

## Radio me ritransmetim

|                                     |                                                                          |      |        |
|-------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|------|--------|
| Radio "CRI Radio e Jashtme e Kinës" | Shoqëria "Alb-CRTV" sh.p.k                                               | CRTV | (100%) |
| Radio BBC                           | Subjekt publik nga Mbretëria e Bashkuar/Përfaqësuar në Shqipëri nga RTSH |      |        |
| Radio RFI                           | Subjekt publik nga Franca/Përfaqësuar në Shqipëri nga Ambasada Franceze  |      |        |

## KABLLORË

| OSHMA                      | Subjekti fizik/juridik                | Pronësia                                   |
|----------------------------|---------------------------------------|--------------------------------------------|
| TV kabllor "Irla"          | Shoqëria "Irla" sh.p.k.               | Irakli Kuqo (100%)                         |
| TV kabllor "Inkusat"       | Person fizik                          | Artan Zhiva                                |
| TV kabllor "HB-CA"         | Person fizik                          | Hajri Hoxha                                |
| TV kabllor "Iliria"        | Person fizik                          | Eduart Azizolli                            |
| TV kabllor "Korça"         | Shoqëria "MRM" sh.p.k.                | Krisanthi Koçibelli (100%)                 |
| TV kabllor "Ani"           | Person fizik                          | Manushaqe Dervishi                         |
| TV kabllor "Kuçova"        | Person fizik                          | Eduart Feka                                |
| TV kabllor "Mati"          | Shoqëria "Vani" sh.p.k.               | Luftim Vani (100%)                         |
| TV kabllor "Asparag"       | Person fizik                          | Bardhyl Tosku                              |
| TV kabllor "Bulqiza"       | Shoqëria "Mariuxho" sh.p.k.           | Edmond Isaku (100%)                        |
| TV kabllor "Kukësi"        | Shoqëria "Televizioni Kukësi" sh.a.   | Lutfi Meçka (60%)<br>Remzije Meçka (40%)   |
| TV kabllor "Fokus"         | Shoqëria "Focus Cable" sh.p.k.        | Naun Prifti (20%)<br>Dudi Bici (80%)       |
| TV kabllor "Delvina"       | Person fizik                          | Adriatik Bajrami                           |
| TV kabllor "KL-ED"         | Shoqëria "KI-Ed Kabëll" sh.p.k.       | Doklead Ademi (100%)                       |
| TV kabllor "IR-GEN"        | Shoqëria "Ir-Gen" sh.p.k.             | Bashkim Graçi (100%)                       |
| TV kabllor "Eri A&A"       | Shoqëria "Eri A&A" sh.p.k.            | Altin Hoxha (100%)                         |
| TV kabllor "Tepelena Sat"  | Person fizik                          | Dritan Memushi                             |
| TV kabllor "Shijaku"       | Shoqëria "TV Kabllor Shijaku" sh.p.k. | Shkelqim Berhami (50%)<br>"Tring TV" (50%) |
| TV kabllor "Ura Vajgurore" | Person fizik                          | Milika Nito                                |
| TV kabllor "Divjaka"       | Person fizik                          | Gentian Kusta                              |



| OSHMA                      | Subjekti fizik/juridik                  | Pronësia                                                        |
|----------------------------|-----------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|
| TV kabllor "Përrenjas"     | Person fizik                            | Ergys Çaushti                                                   |
| TV kabllor "Maqellara"     | Shoqëria "Maqellara TV Kabllor" sh.p.k. | Irfan Nasufi (50%)<br>Arbina Capa (50%)                         |
| TV kabllor "Tërbufi"       | Person fizik                            | Shpresa Boriçi                                                  |
| TV kabllor "Jug"           | Shoqëria "Intel Media" sh.p.k.          | Rexhep Himo (33%)<br>Shan Sulejmani (33%)<br>Erion Marini (34%) |
| TV kabllor "Tata Junior"   | Shoqëria "Tata Junior" sh.p.k.          | Ervin Tahiri (100%)                                             |
| TV kabllor "Vjosa"         | Person fizik                            | Shezai Aliaj                                                    |
| TV kabllor "Toshkëz"       | Person fizik                            | Mikel Jaho                                                      |
| TV kabllor "M&G"           | Person fizik                            | Gentian Biçiku                                                  |
| TV kabllor "Pupa"          | Person fizik                            | Eneritan Pupa                                                   |
| TV kabllor "2 ASL"         | Shoqëria "TV Best Channel" sh.p.k.      | Andrea Asllani (100%)                                           |
| TV kabllor "Brado"         | Person fizik                            | Elion Boriçi                                                    |
| TV kabllor "Lapardha"      | Person fizik                            | Shaban Merkaj                                                   |
| TV kabllor "Mamurras"      | Person fizik                            | Gjergj Gega                                                     |
| TV kabllor "Masa Grup"     | Shoqëria "Masa Grup 2009" sh.p.k.       | Rudina Xhambazi (50%)<br>Aurora Koro (50%)                      |
| TV kabllor "Andor"         | Person fizik                            | Dorina Marini                                                   |
| TV kabllor "Vlora Cable"   | Shoqëria "Vlora Cable" sh.p.k.          | Vexhi Danaaj (40%)<br>Ndue Guri (30%)<br>Nexhmedin Danaaj (30%) |
| TV kabllor "Elbasan Cable" | Shoqëria "Elbasan Cable" sh.p.k.        | Edmond Kristo (35%)<br>Tring TV (65%)                           |
| TV kabllor "Amaregi"       | Person fizik                            | Agron Beqiri                                                    |

| OSHMA                         | Subjekti fizik/juridik                | Pronësia                                                                                             |
|-------------------------------|---------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TV kabllor "Tivo Cable"       | Person fizik                          | Arben Lame                                                                                           |
| TV kabllor "Libcom"           | Person fizik                          | Dashamir Pali (100%)                                                                                 |
| TV kabllor "TVM Devolli"      | Shoqëria "TVM Devolli" sh.p.k.,       | Nevruz Mersuli (100%)                                                                                |
| TV kabllor "Sin – Tel"        | Shoqëria "SIN-Tel" sh.p.k.            | Ismir Basha (90%)<br>Spiro Dhjamandi (10%)                                                           |
| TV kabllor "Sulova"           | Person fizik                          | Besim Sula                                                                                           |
| TV kabllor "Vaqqar"           | Person fizik                          | Edmond Manja                                                                                         |
| TV kabllor "Best Cable"       | Shoqëria "Best Cable" sh.p.k.         | Andrea Asllani (50%)<br>Xhevahir Kalemani (50%)                                                      |
| TV kabllor "Sky Elbasan"      | Shoqëria "Sky Elbasan" sh.p.k.        | Leonard Prifti (50%)<br>Arjan Koka (50%)                                                             |
| TV kabllor "J&P Pro"          | Shoqëria "J&P Pro" sh.p.k.            | Gjergji Toshi (100%)                                                                                 |
| TV kabllor "Beqaj"            | Shoqëria "Beqaj kabllor 2014" sh.p.k. | Gazmir Beqaj (100%)                                                                                  |
| TV kabllor "Erden"            | Person fizik                          | Krenar Goga                                                                                          |
| TV kabllor "Tele.co. Albania" | Shoqëria "Tele.co.Albania" sh.p.k.    | Vladimir Cobo (18%)<br>Agim Cobo (18%)<br>Astrit Cobo (20%)<br>Shezai Cobo (26%)<br>Ismet Cobo (20%) |
| TV kabllor "Laçi"             | Person fizik                          | Pashk Laska                                                                                          |
| TV kabllor "Drini"            | Person fizik                          | Liberta Thanza                                                                                       |
| TV kabllor "Manza"            | Shoqëria "Priam net" sh.p.k.          | Muharrem Sula (100%)                                                                                 |
| TV kabllor "3 Net Digital"    | Shoqëria "3 Net Digital" sh.p.k.      | Xhevdet Poshja (50%)<br>Xhevdet Rusta (10%)<br>Astrit Elezi (40%)                                    |
| TV kabllor "Aral"             | Person fizik                          | Guri Meko                                                                                            |

| OSHMA                        | Subjekti fizik/juridik                    | Pronësia                                                                              |
|------------------------------|-------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| TV kabllor "E & G"           | Person fizik                              | Endri Leka                                                                            |
| TV kabllor "Topojë"          | Person fizik                              | Aristir Kërri                                                                         |
| TV kabllor "Digital"         | Shoqëria "Sabatel" sh.p.k.                | Izder Avdulla (30%)<br>Avdul Yzeiri (30%)<br>Sali Saliu (30%)<br>Nisatel (10%)        |
| TV kabllor "APT"             | Shoqëria "APT Cable" sh.p.k.              | Kostandina Thanasi (100%)                                                             |
| Tv kabllor "ABCom"           | Shoqëria "ABCom" sh.p.k.                  | Vodafone Albania sh.a. (100%)                                                         |
| Besëlidhja                   | Person fizik                              | Preng Doda                                                                            |
| Tv kabllor "Pro Com"         | Shoqëria "Procom" sh.p.k                  | Florenc Karaj (50%)<br>Nexhip Miraka (50%)                                            |
| Tv kabllor "Alb Vito Peqin"  | Person Fizik                              | Albi Kreci                                                                            |
| Tv kabllor "ITCom"           | Shoqëria "Itcom" sh.p.k.                  | Marin Palushi (100%)                                                                  |
| Tv kabllor "IBEG4"           | Person fizik                              | Edmond Çuli                                                                           |
| Tv kabllor "Network Albania" | Person fizik                              | Taulant Hajdini                                                                       |
| "Netsyscom Tv"               | shoqëria "Netsyscom" sh.p.k.              | Dedë Bukaqeja (100%)                                                                  |
| Tv kabllor "1Click.al"       | Shoqëria "1Click.al" sh.p.k.              | Skerdilajd Muho (100%)                                                                |
| Tv kabllor "AFS"             | Shoqëria " Albanian Fiber System" sh.p.k. | Arian Gabaj (25%)<br>Agim Biberaj (25%)<br>Besnik Nanaj (25%)<br>Dritan Shameti (25%) |

## SHËRBIMET E TJERA

| OSHMA                                                        | Subjekti fizik/juridik       | Pronësia                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|--------------------------------------------------------------|------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Tring Tv OTT                                                 | Shoqëria "Tring TV" sh.a.    | Holta Dulaku (33%)<br>Melina Dulaku (33%)<br>Ridvana Dulaku (34%)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Tibo OTT                                                     | Shoqëria "Tibo" sh.p.k.      | Vjosa Kalemi (20%)<br>Adnand Mahmuti (42%)<br>Marina Rama (38%)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Abissnet OTT                                                 | Shoqëria "Abissnet" sh.a.    | 2K Group (100%)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Nisatel OTT                                                  | Shoqëria "Nisatel" sh.p.k    | Sadrit Danaj (45%)<br>Shoqëria "Telecom & Energy Holding" sh.p.k. (55 %)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Digitalb OTT                                                 | Shoqëria "Digit-Alb"sh.a.    | Agim Zeqo (2.79%)<br>Alban Jaho (3%)<br>Itan Hoxha (8.56%)<br>Samir Mane (1.32 %)<br>Alba Gina (2.17%)<br>Enkelejd Joti (2.52 %)<br>Eduard Poda (1.52 %)<br>Redia Hoxha (4.19%)<br>Shoqëria "DEM Capital" sh.p.k. (8.90%)<br>Arch Investor (3.20%)<br>Shoqëria "A.I.B.A. kompani" sh.a. (9.23%)<br>Shoqëria "E&E INVESTMENT" sh.p.k. (8.90 %)<br>Shoqëria "UNION GRUP" sh.p.k. (6.80 %)<br>Shoqëria "Union Distribucion Servis Albania" sh.p.k. 6.80%)<br>Shoqëria "LORESA" sh.p.k. (30.70%) |
| Albtelecom<br>Përsëritës shërbimi<br>mbështetur në IPTV OTT  | Shoqëria "Albtelecom" sh.a.  | Posta Shqiptare (2,47%)<br>Ministria e Ekonomisë,Tregtisë dhe Energjitikës (13,78%)<br>CETEL TELEKOM ILETISIM SANAYI VE TICARET ANONIM SIRKETI (80,27%)<br>Aksionarë të tjerë (3,48%)                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Bleta IPTV                                                   | Shoqëria "Bleta" sh.p.k.     | Bledar Rrushi (50%)<br>Arian Simo (50%)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Next - TV<br>Ofrues shërbimi online<br>dhe përsëritës në OTT | Shoqëria "Next - Tv" sh.p.k. | Vasil Luadhi (100%)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |

| OSHMA                            | Subjekti fizik/juridik                           | Pronësia                                                                                                                                                  |                                            |
|----------------------------------|--------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|
| STV Në internet                  | Shoqëria "Radio Televizioni Super Sonic" sh.p.k. | Diana Hoxha Cerova<br>Riza Hoxha Cerova<br>Altin Çela                                                                                                     | (15%)<br>(15%)<br>(70%)                    |
| STV Folk Në internet             | Shoqëria "Radio Televizioni Super Sonic" sh.p.k. | Diana Hoxha Cerova<br>Riza Hoxha Cerova<br>Altin Çela                                                                                                     | (15%)<br>(15%)<br>(70%)                    |
| Elrodi TV Në internet            | Person Fizik                                     | Elida Llupa                                                                                                                                               |                                            |
| 3 N 1 TV<br>Ofrues rrjet kabllor | Shoqëria "Vodafone Albania" sh.p.k.              | Vodafone Europe B.V.<br>Vodafone Panafon International Holding                                                                                            | 50% të kuotave.<br>B.V. 50% të kuotave.    |
| Tv Info Channel<br>IPTV/OTT      | Shoqëria "Albtelecom" sh.a.                      | Posta Shqiptare<br>Ministria e Ekonomisë,Tregtisë dhe Energjitikës<br>CETEL TELEKOM ILETISIM<br>SANAYI VE TICARET<br>ANONIM SIRKETI<br>Aksionarë të tjerë | (2,47%)<br>(13,78%)<br>(80,27%)<br>(3,48%) |
| Zjarr TV Online                  | Person fizik                                     | Ismet Drishti                                                                                                                                             |                                            |
| Tema TV Në internet              | Shoqëria "Tema TV" sh.p.k.                       | OTTIG                                                                                                                                                     | (100%)                                     |
| Premium Travel<br>Online         | Shoqëria "PREMIUM MEDIA" sh.p.k.                 | Gentian Ferhati<br>Enver Mehmeti                                                                                                                          | (30%)<br>(70%)                             |
| Eden 3 Në rrjet kabllor          | Person fizik                                     | Gladiola Shehaj                                                                                                                                           |                                            |
| City Tv Në internet/OTT          | Shoqëria "Triangle Media Group" sh.p.k.          | Genc Gjineci                                                                                                                                              | (100%)                                     |
| Telesport Në rrjet satelitor     | Shoqëria "Telesport" sh.p.k.                     | Perla Malo<br>Miranda Malo<br>Migena Malo<br>Hauard Malo<br>Enklajd Malo                                                                                  | (20%)<br>(20%)<br>(20%)<br>(20%)<br>(20%)  |
| Tv Gold Online                   | Shoqëria "Tv Gold" sh.p.k.                       | Artan Xhaferri<br>Ardjana Merko                                                                                                                           | (60%)<br>(40%)                             |
| TV Lezha<br>Në internet/OTT      | Person fizik                                     | Fred Stakaj                                                                                                                                               | (100%)                                     |

| OSHMA                                 | Subjekti fizik/juridik                | Pronësia                                                                                                                                           |
|---------------------------------------|---------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| T 4+<br>Në rrjet kabllor              | shoqëria "4 Plus Media Group" sh.p.k. | Gëzim Koçiu (100%)                                                                                                                                 |
| I.B.C. Telecom OTT                    | Shoqëria "I.B.C. - Telecom" sh.p.k    | Gjergji Ejlli (100%)                                                                                                                               |
| Tele. Co. Albania<br>Në rrjet kabllor | Shoqëria "Tele.Co.Albania" sh.p.k.    | Vladimir Cobo (18%)<br>Agim Cobo (18%)<br>Astrit Cobo (20%)<br>Shezai Cobo (26%)<br>Ismet Cobo (20%)                                               |
| Network Albania<br>Në rrjet kabllor   | Person fizik                          | Tauland Hajdini                                                                                                                                    |
| Adria Net<br>Në rrjet kabllor         | Person fizik                          | Kristi Gorea                                                                                                                                       |
| Net 3 Digital Tv<br>Në rrjet kabllor  | Shoqëria "Net 3 Digital" sh.p.k       | Xhevdet Poshja (50%)<br>Xhevdet Rusta (10%)<br>Astrit Elezi (40%)                                                                                  |
| My TV Alb OTT                         | Shoqëria "My TV Alb" sh.p.k           | Arlinda Ademi (34%)<br>Iglli Cara (33%)<br>Arian Cara (33%)                                                                                        |
| RRTL-OTTOTT                           | Shoqëria "RRTL-OTT" sh.p.k            | Luftim Vani (17%)<br>Rezart Çobo (16,6%)<br>Albert Balla (16,6 %)<br>Edmond Isaku (16,6 %)<br>Ardian Ukaj (16,6 %)<br>Krisanthi Koçibelli (16,6 %) |
| DIGICOM IPTV                          | Shoqëria "Digicom" sh.p.k.            | Shoqëria "Albanian<br>Telecommunications Union" sh.p.k. (85%)<br>Marin Gjonaj (15%)                                                                |
| KLANI IM<br>OTT                       | Shoqëria "Tv Klan" sh.a.              | Alba Gina (40%)<br>Aleksandër Frangaj (60%)                                                                                                        |

### III. Karakteristika të personelit të angazhuar në OSHMA-të

Rekrutimet dhe menaxhimi i burimeve njerëzore në subjektet audio dhe audiovizive kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në larminë dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve që ato ofrojnë.

Në këtë seksion jepen disa nga treguesit kryesorë të përbërjes së stafëve si dhe pjesa e trajtimit të tyre në raport me të ardhurat dhe shpenzimet që bëjnë OSHMA-të. Të dhënat që vijojnë bazohen në vetëdeklarimet e subjekteve audio dhe audiovizive në institucionet përkatëse.


- Bazuar të dhënave për vitin 2020 tek televizionet janë rreth 2905 punonjës, tek radiot janë rreth 303 punonjës, tek kabllorët 362 punonjës dhe tek shërbimet e tjera 1520 punonjës.

#### 4. Strukturimi i stafëve sipas nivelit arsimor, moshës, vjetërsisë në punë, gjinisë dhe profesioneve

##### 4.1 Arsimimi i punonjësve


#### ■ Televizionet

Në personelin e angazhuar në televizione, pjesa më e madhe e të punësuarve, përkatësisht 66%, kanë kryer arsimin e lartë, 31% janë me arsim të mesëm, si dhe 1% me arsim tetëvjeçar. Në këtë kategori janë të angazhuar edhe studentë.



## ■ Radiot


Të punësuarit në radio me arsim të lartë janë në nivelin 68%. 31% e këtij personeli janë me arsim të mesëm dhe 1% rezultojnë të jenë studentë.



## ■ Kabllorët

Ndryshe nga subjektet audio dhe televizione, përqindja më e lartë e të punësuarve është me nivelin e arsimit të mesëm, përkatësisht 55%, ndërsa 40% kanë kryer arsimin e lartë dhe vetëm 5% e tyre janë me arsim tetëvjeçar.


Nuk rezulton asnjë student i punësuar pranë këtyre OSHMA-ve.





## ■ Shërbimet e tjera


Ajo që vihet re në këtë kategori është se shumica e të punësuarve, mbi 68%, janë me arsim të lartë, 30% të të punësuarve janë me arsim të mesëm, ndërsa me arsim tetëvjeçar janë afërsisht 2%.



## 4.2 Moshë


### Televizione

Në tregun televiziv grupmosha 18-35 vjeç zë peshën më të madhe të stafit me 40 %, duke vijuar me grupmoshën 36-45 që zënë 36 % të stafit. Punonjës me moshën mbi 61 vjeç kemi vetëm 5 %.




### Radio

Në stafin radiofonik grupmosha 18-35 vjeç zë 36%. Ndërsa grupmosha 36-45 zë 41% të stafit të angazhuar në këtë sektor.




## Kabllorë

Grup moshë 20-35 vjeç ka përqindjen më të lartë të të punëuarve në këtë kategori shërbimi, me 17 %, ndërsa grupmosha prej 66 deri 75 vjeç zë përqindjen më të vogël, 0,5%.



## Shërbimet e tjera

Edhe në subjektet e shërbimeve të tjera shihet një përqindje e lartë e moshës më të re, asaj prej 18 deri në 30 vjeç, si dhe një përqindje e ulët e grupmoshës 66-70 vjeç.




### 4.3 Vjetërsia në punë


#### ■ Televizionet

Më poshtë do të shohim të paraqitur grafikisht re se 48% e stafit kanë një eksperiencë pune nga 0-3 vjet.

Kjo gjë evidenton shqetësimet e herë pas hershme të vlerësimeve nga ekspertët për punën pa kontrata pune, në ekipe të paqëndrueshme dhe të papërvojë.





Ne këtë grafik prezantohet struktura e detajuar për të punësuarit deri në një vit punë.





## ■ Radiot

Në subjektet audio shihet se ka më tepër qëndrueshmëri në jetëgjatësinë e të punësuarve. Më tepër se gjysma e stafit kanë vjetërsi pune nga 3 deri në 10 vjet.





## Kabllorët

Ndërsa tek të punësuarit në subjektet kabllorë shihet qartë se stafi është më i paqendrueshëm. Pra, 65% e të punësuarve kanë 1 deri në 3 vjet punë.



## ■ Shërbimet e tjera

Gjithashtu, të njëjtën situatë e gjejmë të reflektuar edhe tek personeli në shërbimet e tjera.




4.4 Balanca gjinore

Po të shohim në grafikët e mëposhtëm, vërejmë se, përqindja më e lartë e të punësuarve në televizione, radio, kabllorë dhe shërbime të tjera, është meshkuj. Gratë e angazhuara në OSHMA zënë pothuajse 1/3 e të gjithë të punësuarve në këto subjekte.


Televizione

- Femra
- Meshkuj



Radio


- Femra
- Meshkuj






## Kabllorë

- Femra
- Meshkuj



## Shërbimet e tjera

- Femra
- Meshkuj



#### 4.5 Vlerësim gjinor në angazhimin e përmbajtjeve audiovizive të transmetuara

Subjektet audiovizive në strukturën e tyre programore përfshijnë emisione ose rubrika që transmetohen çdo ditë, një ose disa herë në javë, ose me periodicitet kohor më të rrallë. Një pjesë e tyre kanë dhe karakter sezonal, duke u emetuar në një periudhë të caktuar të vitit, varësisht fokusit tematik dhe target-it.

Më poshtë pasqyrohet angazhimi i pjesëmarrësve (femra/meshkuj) në programe të ndryshme, ndarë në dy kategori: moderatorë dhe të ftuar. Kampioni kohor i përcaktuar është periudha e transmetimit 07 deri në 13 dhjetor 2020.

Vlerësimi është bërë në 11 subjekte audiovizive (kombëtare si dhe lokale/rajonale), konkretisht RTSH 1, Klan, Top Channel, Vizion Plus, News 24, Ora News, ABC News, Report TV, Fax News, A2 dhe EuroNews Albania.

Në të dhënat e paraqitura, në vlerë absolute dhe në përqindje, për secilin nga subjektet, identifikohen në mënyrë sasiore moderatorët e programeve, si dhe të ftuarit, ndarë sa prej tyre janë meshkuj dhe sa femra.



Rezultatet e kampionit që është vlerësuar reflektojnë për secilin nga subjektet audiovizive, por dhe në tërësi, prirjen se, ekrani po afron për kontribute të dyja gjinitë, pa qenë pengesë dhe paragjykim për cilindo që ngarkohet me detyrën e moderimit të një programi, apo për ata që ftohen të ndajnë mendimet e pikëpamjet në trajtimin e temave dhe aspekteve që subjekti audioviziv vendos në fokus.

#### Vlerësimi gjinor i angazhimit në programe Periudha e kampionimit 7 – 13 dhjetor 2019



| Subjekti         | Nr. moderatorëve |         |       | Nr. të ftuarve |         |       |
|------------------|------------------|---------|-------|----------------|---------|-------|
|                  | Gjithsej         | Meshkuj | Femra | Gjithsej       | Meshkuj | Femra |
| RTSH 1           | 24               | 9       | 15    | 52             | 26      | 26    |
| Klan             | 41               | 28      | 13    | 184            | 76      | 108   |
| Top Channel      | 103              | 54      | 49    | 367            | 228     | 139   |
| Vizion Plus      | 80               | 38      | 42    | 157            | 92      | 65    |
| News 24          | 89               | 31      | 58    | 89             | 50      | 39    |
| Ora News         | 59               | 28      | 31    | 131            | 62      | 69    |
| Report Tv        | 65               | 19      | 46    | 100            | 67      | 33    |
| ABC News         | 93               | 44      | 49    | 152            | 118     | 34    |
| Fax News         | 105              | 25      | 80    | 120            | 93      | 27    |
| A2               | 85               | 55      | 30    | 60             | 41      | 19    |
| EuroNews Albania | 43               | 19      | 24    | 97             | 80      | 17    |

## Raporti femra/meshkuj përkthyer në përqindje


### RTSH1





### Klan





### Top Channel





Vizion Plus




News 24




Ora News





## Report Tv




## ABC News




## Fax News



## A2



## EuroNews




## 4.6 Struktura sipas profesioneve

### Televizione

Në ndryshim nga një vit me parë, në strukturimin e stafit sipas profesionit, në subjektet televizive, mbizotërojnë stafi teknik, të cilët rezultojnë me 31%, ndjekur nga stafi i gazetarëve me 30% dhe në vendin e tretë renditet stafi i shërbimeve të brendshme me 11%.



#### Përbërja e stafit në % sipas profesionit



### Radio

Edhe në subjektet radiofonike stafi teknik ka përqindjen më të madhe, me 27%. Në përbërjen e stafit të kësaj kategorie ka një përqindje minimale, me 1%, stafi artistik.

#### Përbërja e stafit në % sipas profesionit




## Kabllorë

Operatorët kabllorë, duke qenë se ofrojnë për abonentët e tyre ripërsëritjen e programeve të të tretëve, atëherë dhe pjesa më e madhe e stafit përfshihet nga stafi i shërbimeve të brendshme me 36% dhe ndiqet nga stafi teknik me 33%.

### Përbërja e stafit në % sipas profesionit

- Stafi Drejtues
- Stafi Administratës
- Stafi Shërbimeve të Brendshme
- Stafi Teknik




## Shërbime të tjera

Për nga vetë natyra e shërbimeve të tjera, ku përfshihen OTT, IPTV, etj, përqindja më e lartë i takon stafit teknik me 42%, ndjekur nga stafi i administratës me 30% dhe stafi i shërbimeve të brendshme me 11%.

### Përbërja e stafit në % sipas profesionit

- Staf Teknik
- Staf i Shërbimeve të Brendshme
- Staf i Administratës
- Staf Drejtues
- Programacion







## 5. Trajtimi i personelit në raport me të ardhurat dhe shpenzimet

### 5.1 Strukturimi i pagave bruto sipas ndarjes në profesione të stafit

Në grafikët e mëposhtëm pasqyrohen përqindjet e grupimeve të personelit (teknika, shërbimet e brendshme, gazetarët, administrata etj.) dhe përqindjet përkatëse që zë fondi i pagave për secilën prej grupimeve në raport me totalin e këtij fondi. Për të treguar trendin, janë paraqitur pagat e muajit janar dhe korrik të vitit 2020.


## Televizione

Nga grafikët më poshtë shihet se në raportet për secilin nga grupimet kryesore të stafit kemi një përqendrim më të lartë të pagave tek gazetarët. Pagat e tyre zënë 33% të fondit të përgjithshëm për muajt janar dhe korrik.




## Radio

Në subjektet audio është stafi teknik që kryeson, i pasuar nga stafi gazetar, në totalin e pagave për muajin korrik.




- % e ndarjes së stafit sipas profesionit
- % sipas totalit të pagave për muajin janar



- % e ndarjes së stafit sipas profesionit
- % sipas totalit të pagave për muajin korrik


## Kabllorë

Tek subjektet kabllore vihet re se stafi i shërbimeve të brendshme dhe stafi teknik kanë përqindjen më të lartë të pagave, përkatësisht me 36% dhe 31% për janarin dhe 37% dhe 31% për korrikun.



■ % e stafit sipas profesionit

■ % e stafit sipas totalit të pagave janar




■ % e stafit sipas p ofesionit

■ % e stafit sipas totalit të pagave kor ik


## ■ Shërbimet e tjera

Në kategorinë e shërbimeve të tjera, stafi teknik dhe ai i administratës kanë përqindje të barabartë për të dy muajt.



■ % e ndarjes sipas profesionit

■ % sipas totalit të pagave janar



■ % e ndarjes sipas profesionit



■ % sipas totalit të pagave korrik

## 5.2 Dinamika e fondit të pagave bruto sipas grupimeve të profesioneve

Në grafikët e mëposhtëm jepen lëvizjet në përqindje të fondit të pagave bruto për OSHMA-të sipas grupeve kryesore të personelit (staf teknik, shërbimet e brendshme, gazetarët etj) në tri periudha të çdo 6-mujori të vitit 2020, janar, mars, qershor, korrik, shtator, dhjetor.



### ■ Televizionet

Nga grafikët e mëposhtëm shohim se ka një luhatje pagash të pa përfillshme, me rreth 1% për të dy gjashtëmujorët.





## Radiot

Edhe në subjektet audio ka stabilitet në përqindjet që zënë pagat në grupimet kryesore të personelit. Nga fillimi i muajit janar deri në muajin dhjetor ndryshimi i pagave luhet me 1 ose 2%. Shumica e fondit të pagave shkon për gazetarët, ndjekur nga stafi teknik.



### Kabllorët



Në grafikun e subjekteve kabllorë stafi i shërbimeve të brendshme dhe stafi teknik kanë përqindje më të lartë të fondit të pagave.





■ Shërbime të tjera


Për subjektet e autorizuar nga AMA për këto shërbime pjesa më e konsiderueshme e fondit të pagave shkon për stafin teknik, ndërsa përqindjen më të ulët të pagave e ka stafi i programacionit, duke pasur parasysh se pjesa dërrmuese e këtyre subjekteve nuk prodhojnë kontent.





5.3 Përqendrimi i personelit të OSHMA-ve sipas nivelit të pagës

Televizione


Duke iu referuar grafikëve të mëposhtëm vihet re se më shumë se 50% e personelit të punësuar pranë subjekteve të licencuar nga AMA, paguhen me një pagë në nivelit mesatar nga 40-60 mijë lekë, që përbën dhe përqendrimin më të madh të të punësuarve.









% e lëvizjeve të stafit




**Radio**

Në rastin e mëposhtëm, niveli mesatar i pagave mbizotëron në fashën 26-40 mijë lekë.











## % e lëvizjeve të stafit




## Kabllorë


Në këtë kategori subjektsh vihet re fakti që gati 65% të të punësuarve paguhet në nivelin e pagës mesatare të miratuar në rang vendi.

Nga të gjitha OSHMA-të, kabllorët kanë lëvizjen më të madhe të stafit.







% e lëvizjeve të stafit




## Shërbime të tjera


Të punësuarit në tregun e kategorisë së shërbimeve të tjera paguhen më shumë (rreth 62% e tyre) me pagë mesatare midis vlerës 26.000- 60.000 lekë.







# % e lëvizjeve të stafit





## 5.4 Raporti i pagave bruto mbi të ardhurat dhe shpenzimet vjetore totale


Në këtë seksion jepet paraqitja grafike e shpërndarjes së numrit të OSHMA-ve për segmentet e raporteve të: pagav/ të ardhura dhe paga/ shpenzime, sipas bilanceve të raportuara gjatë vitit 2020, në kategoritë televizione, radio, kabllorë dhe shërbime të tjera.

### ■ Televizione


Për sa i takon raportit të pagave mbi të ardhurat, numri më i madh i subjekteve, 26% e tyre, përqendrohet në segmentet: 1-20% dhe 30-40%.

Ndërsa në raportin e pagave mbi shpenzimet shihet se përqendrimi më i madh i subjekteve, 22% e tyre kanë, po ashtu, në segmentet: 1-20% dhe 50-60%.


### Paraqitja e radiove sipas raportit në % të shpenzimeve të personelit mbi totalin e të ardhurave/shpenzimeve



Përqendrimi i TV për raportin paga/të ardhura



Përqendrimi i TV për raportin paga/shpenzime




## Radio


Tek radiot shohim se përqindja më e madhe e subjekteve, 30%, janë në segmentin 1 – 20% në raport të pagave me të ardhurat.

Ndërsa në raportin e pagave mbi shpenzimet segmenti 50-60% ka vlerën 25%.


### Paraqitja e radiove sipas raportit në % të shpenzimeve të personelit mbi totalin e të ardhurave/shpenzimeve



Përqendrimi i radiove për raportin paga/të ardhura




Përqendrimi i radiove për raportin paga/shpenzime




## Kabllorë

Tek kjo kategori, përqendrimi me rreth 70%, e kanë raportin e pagave mbi të ardhurat vjetore në segmentin 1 – 20% dhe me një diferencë të vogël, rreth 73%, e kanë raportin e pagave mbi shpenzimet vjetore po në këtë segment.


### Paraqitja e kabllorëve sipas raportit në % të shpenzimeve të personelit mbi totalin e të ardhurave/shpenzimeve



Përqendrimi i kabllorëve për raportin paga/të ardhura




Përqendrimi i kabllorëve për raportin paga/shpenzime




## ■ Shërbime të tjera

Tek subjektet e licencuara për shërbime të tjera, rreth 45%, e kanë raportin e pagave mbi të ardhurat vjetore në segmentin 1-20% dhe 41% kanë raportin e pagave mbi shpenzimet vjetore po në këtë segment.


**Paraqitja e shërbimeve të tjera sipas raportit në % të shpenzimeve të personelit mbi totalin e të ardhurave/shpenzimeve**



**Përqendrimi i shërbimeve të tjera për raportin paga/të ardhura**



**Përqendrimi i shërbimeve të tjera për raportin paga/shpenzime**





## IV. Treguesit teknikë të transmetimeve të OSHMA-ve

### 6. Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive

Viti 2020 shënon përfundimin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive në vendin tonë, këtij procesi të vështirë, të tejzgjatur në kohë dhe të shoqëruar me mjaft problematika, duke përmbushur kështu një detyrim kombëtar, ndërkombëtar si dhe kërkesat në rritje të qytetarëve.

Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive konsiderohet një ndër arritjet kryesore në fushën e medias, duke qenë se përfitimet nga ky proces i rëndësishëm janë të shumta dhe të prekshme për publikun shqiptar. Rritja e numrit të kanaleve televizive pa pagesë, rritja e cilësisë së shërbimit, rritja e ndërveprimit, gama e gjerë e shërbimeve të reja janë disa nga këto përfitime.

Kjo arritje i adresohet, kryesisht, rregullatorit, i cili ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm, në ndjekjen e implementimit të këtij procesi, duke garantuar vijueshmërinë e transmetimeve televizive në këtë periudhë të vështirë tranzicioni, si dhe duke siguruar mbulim me sinjal numerik tokësor dhe cilësi transmetimi brenda standardeve ndërkombëtare. AMA, gjatë vitit 2020, në mënyrë të vazhdueshme ka koordinuar punën me operatorët audiovizivë në treg, ka kryer monitorime në terren, ka zhvilluar fushatën e informimit për qytetarët, u ka ardhur në ndihmë qytetarëve nëpërmjet strukturës Call Center, të ngritur nga Autoriteti, si dhe ka zhvilluar anketime nëpërmjet kësaj strukture me qëllim identifikimin e pajisjes me dekodera të qytetarëve. Përfundimi i procesit u realizua me mbylljen e transmetimeve analoge, gjatë këtij viti, në qarqet Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë më 30.09.2020, si dhe në qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastër më 30.12.2020.

Me kalimin në transmetime numerike, numri i kanaleve kombëtare, të aksesueshme për publikun shqiptar, është rritur ndjeshëm. Krahasuar me tre kanalet televizive në nivel kombëtar, ku njëri kanal ofrohej nga operatori publik shqiptar (RTSH) dhe dy kanalet e tjera nga operatorët privatë, sot vetëm RTSH transmeton pa pagesë në të gjithë Shqipërinë 15 kanale televizive nga të cilët 3 janë gjeneralistë dhe 10 të tjerat tematike, për grupe të ndryshme shoqërore, si RTSH Fëmijë, RTSH Sport, RTSH Muzikë, RTSH Film, RTSH Kuvend etj. Duke konsideruar edhe kanalet e tjera të ofruara nga operatorët privatë kombëtare dhe operatorët lokalë, në çdo qark të vendit, qytetarët shqiptarë mund të shohim mbi 30 kanale televizive pa pagesë.

Dy rrjetet numerike të operatorit publik shqiptar dhe pesë rrjetet numerike private tashmë ofrojnë përmbajtje të ndryshme në nivel kombëtar (në standardet SD dhe HD), një gamë të gjerë shërbimesh të reja, zgjedhje shumë të pasur dhe konkurruese në krahasim me platformat e tjera. Aktualisht në qarqet Tiranë, Durrës ofrohen 38 kanale pa pagesë, në

në qarkun Korçë ofrohen 37 kanale, në qarkun Berat 35 kanale, në qarkun Fier 33 kanale, në qarkun Vlorë 36 kanale, në qarkun Shkodër 40 kanale, në qarkun Lezhë 34 kanale, në qarkun Elbasan 38 kanale, në qarkun Kukës 26 kanale, në qarkun Dibër 28 kanale dhe në qarkun Gjirokastër 36 kanale të lira, pa pagesë.

Në fillim të këtij procesi njerëzit kanë qenë skeptikë dhe paragjykues lidhur me atë çfarë do të ndodhte, pasi ka qenë një proces teknik i vështirë edhe për t'u kuptuar, sikurse çdo risi që vjen për shkak të zhvillimeve teknologjike. Me kalimin e kohës dhe pas implementimit të transmetimeve digjitale, kërkesa e qytetarëve për të përfunduar procesin ka qenë e vazhdueshme. Kjo shpjegohet me arsyen e thjeshtë se cilësia e transmetimit është e pakrahasueshme me transmetimet analoge dhe numri i madh i kanaleve televizive pa pagesë ofron një larmishmëri të madhe të programeve televizive.

Vlen të përmendet se kalimi në transmetimin digjital ka përfunduar në shumicën e vendeve evropiane, dhe Shqipëria është ndër vendet e vonuara në këtë proces, por ndërkohë, ndryshe nga shumica e vendeve evropiane, ku aktualisht vijon tranzicioni për kalimin nga teknologjia DVB-T në DVB-T2, vendi ynë bëri zgjedhjen e duhur duke implementuar që në fillim teknologjinë më të fundit DVB-T2/MPEG-4, me qëllim ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë transmetimi.

## 6.1 Mbulimi me sinjal digjital i territorit

Në kuadër të finalizimit të procesit të digjitalizimit, fokusi kryesor, gjatë vitit 2020, sa i takon mbikëqyrjes së shfrytëzimit të spektrit të frekuencave, ka qenë monitorimi në terren lidhur me shtrimin e infrastrukturës numerike nga operatorët privatë kombëtarë audiovizivë, identifikimi i mbulimit me sinjal numerik audioviziv të territorit të vendit si dhe verifikimi i mbështetjes së operatorëve lokalë/rajonalë në rrjetet kombëtarë numerike.

Nga monitorimet e kryera në të gjitha qarqet e vendit, në përfundim të procesit të digjitalizimit, rezulton se RTSH dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë nuk mbulojnë me sinjal numerik zona të caktuara të vendit, si më poshtë:

### 1. OPERATORI PUBLIK SHQIPTAR, RTSH

#### *QARKU BERAT*

- Lagjet mbas Kalasë së Beratit
- Njësia administrative Roshnik
- Njësia administrative Sinjë
- Njësia administrative Potom
- Njësia administrative Çepan.

*Rreth 5 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU KORÇË*

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Çerrave (qendër)
- Njësia administrative Mokërr (pjesërisht)
- Njësia administrative Gorë
- Njësia administrative Barmash.

*Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARQET TIRANË – Durrës*

- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

*Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU ELBASAN*

- Komuna Labinot ( Fushë-Xibrakë)
- Njësia administrative Qukës (pjesërisht)
- Njësia administrative Lunik  
(Kostenjë, Dranovicë, Orenjë, Streblevë).

*Rreth 1 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU VLORE*

- Njësia administrative Borsh (pjesërisht)
- Njësia administrative Himarë (pjesërisht)
- Fshatrat e lumit të Vlorës ( Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velçë, Vranisht, Kuç).

*Rreth 3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU SHKODËR*

- Njësia administrative Ana e Malit.
- Njësia administrative Vau i Dejës (pjesërisht).
- Njësia administrative Kelmend.

*Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU GJIROKASTËR*

- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagore
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Qesarat

- Njësia administrative Dropull i sipërm
- Njësia administrative Pogon.

*Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU DIBËR*

- Njësia administrative Maqellarë (pjesërisht)
- Njësia administrative Sllovë, Kala e Dodës.

*Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU KUKËS*

- Njësia administrative Lek Bibaj.

*Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## **2. SHOQËRIA "MEDIA VIZION"**

#### *QARKU BERAT*

- Njësia administrative Kuçovë
- Njësia administrative Polican
- Njësia administrative Çorovodë.

*Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU KORÇË*

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Njësia administrative Cërravë
- Njësia administrative Mokër.

*Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU TIRANË*

- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë

- Njësia administrative Dropull i sipërm
- Njësia administrative Pogon.

*Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU DIBËR*

